



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:070095
Datë: 19.12.2024
Numri i dokumentit: 06622547

P.nr.307/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-Divizioni Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi-Muçaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit F.K nga fshati, Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë–Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjën PP.II.nr.2435/2023 të datës 01.03.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar të hapur për publikun, të datës 10.12.2024, të mbajtur në prezencën e Prokurorit të shtetit Ermal Demhasaj nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit F.K, mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av.Dukagjin Kërveshi, nga Peja, me datën 11.12.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 19.12.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

F.K, i lindur me datë në Pejë, nga i ati A., e ëma Sh., me mbiemrin vajzërisë, me vendbanim ne fsh.....,rr., Komuna e Pejës, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion, posedon numër te telefonit, i identifikuar me numër personal, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 28.11.2023, rreth orës 17:50, në rr.”.....”, në Pejë, përkatësisht në Stacionin e Autobusëve në Pejë, këtu i pandehuri F.K, në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit për Armë (Ligji Nr. 05/L-022), mban në pronësi dhe kontroll dhe atë 1 (një) pistoletë e markës cal. mm me numër serik A....., një (1) karikator i pistoletës së njëjtë si dhe pesë (5) fishekë të cal.mm, në atë mënyrë, që pasi patrulla e NJRSH-së, ishte në kontroll në vendin e lartcekur, aty vërejnë disa lëvizje të dyshimta tek i pandehuri F.K, ku i njëjti ndalohet nga ana e Policisë

dhe gjatë kontrollit tek i dyshuari në xhepin e majtë të xhaketës është gjetur arma, karikatori si dhe fishekët e cekur më lartë të cilat më pas konfiskohen nga ana e Policisë,

- Me çka ka kryer veprë penale **“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”** nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, në aplikim të neneve 7, 8, 17, 38, 39 par.1 nën par. 1.1, neni 40 par. 1 pika 1.2, 43, neni 69, 70 neni 366 par.1 dhe par.3 të KPRK-së, si dhe nenit 358, 359, 361, 364, 365, 449 par. 1 dhe par. 2 pika 2.6 dhe 462 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, të pandehurin:

E G J Y K O N

- I. Me **DËNIMI ME GJOBË**, në shumën prej gjashtë (500) euro, e të cilin dënim i njëjti obligohet ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i pandehuri dënimin e shqiptuar në të holla dështon, refuzon apo nuk mund të paguajë dënimin me gjobë të përcaktuar si në pikën I të këtij dispozitivi të aktgjykimit, gjykata në bazë të nenit 43 par. 3, të KPRK-së, do t'a zëvendësojë me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20) euro gjobë.
- III. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- IV. Në kuptim të nenit 366 par.3 të KPRK-së, **KONFISKOHET** pistoleta e markës, cal. mm me numër serik, një (1) karikator i pistoletës së njëjtë si dhe pesë (5) fishekë të cal. 9mm, si objekt i veprës penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, me datën 01.03.2024, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2435/2023 kundër të pandehurit F.K, nga fshati, i Komunës së Pejës, për shkak të veprës penale **“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”** nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata me datën 10.12.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale, e konform dispozitës së nenit 240 të KPPRK-së, në të cilën kanë qenë prezentë Prokurori i shtetit Ermal Demhasaj nga Prokuroria Themelore në Pejë, i pandehuri F.K, si dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av. Dukagjin Kërveshi nga Peja.

Në këtë seancë, pasi që gjykata të pandehurit i ka komunikuar të drejtat dhe detyrimet që i takojnë në procedurën penale sipas KPPRK-së, i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar këto të drejta dhe si mbrojtës ka pranuar av. Dukagjin Kërveshi nga Peja.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, gjykata, është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe të njëjtin e ka udhëzuar për kushtet, benefitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, dhe pasi që i pandehuri F.K, është konsultuar me mbrojtësin e tij, dhe ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e pranon fajësinë, për veprën penale që i vihet në barrë, respektivisht për veprën penale “*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*”, nga neni 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 04/L-082 (KPRK), ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit*. Po ashtu, edhe mbrojtësi i të pandehurit i cili deklaroi se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, i njëjti është bërë në konsultim të mjaftueshëm me mua si mbrojtës dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtit t'i aprovohet*.

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti se në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: *Raporti i oficerit L. P. #11406 i datës 27.11.2023; Raporti i oficerit K.S. #11165 i datës 27.11.2023; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 27.11.2023; Deklarata e të pandehurit F.K e dhënë në Prokurorinë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm me datë 29.02.2024; Foto-dokumentacion i shkresave të lëndës, nga të cilat gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit konform nenit 356 të KPPRK-së, pasi që nuk ka nevojë për një seancë të tillë, gjykata ka vazhduar seancën për shqiptimin e dënimit.

Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, në fjalën e tij përfundimtare sa i përket rrethanave rënduese dhe lehtësuese ka deklaruar se: *sa i përket rrethanave rënduese të mirët parasysh ndonjë dënim eventual i mëparshëm ndërkaq si rrethanë lehtësuese pranimi i fajësisë*.

Mbrojtësi i të pandehurit av.Dukagjin Kërveshi, ka deklaruar se: *konsiderojmë se ky pranim fajësie nga ana e të mbrojturit tim i plotëson kushtet ligjore sipas dispozitave të KPRK-së prandaj kërkojmë se përpos pranimin të fajësisë si rrethanë lehtësuese, kërkojmë që të njëjtit ti caktohet një dënim më i ulët me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit, duke marrë parasysh*

rrethanat lehtësuese si bashkëpunimi me organet e ligjit ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë në fillim të kësaj procedure.

I pandehuri F.K, ka deklaruar se: *jam penduar për veprën penale që kam kryer, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera penale, e mbështes deklarinimin e mbrojtësit tim.*

Prandaj, me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*”, nga neni 366 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës 04/L-082 (KPRK).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri ka ekzistuar dashja që vepra penale të kryhet në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e kryera dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj. Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale e të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe gjykata e ka vërtetuar se e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjyqtarja e vetme gjykuese në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethanë posaçërisht lehtësuese mori pranimin e fajësisë që në shqyrtimin fillestar, pendimin e tij për rastin e ndodhur, premtimin që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale, faktin që i njëjti është mbajtës i familjes dhe që i njëjti nuk është i dënuar më parë, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese përveç elementeve të figurës së veprës penale në rastin konkret gjykata nuk gjeti.

Andaj, gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është e bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata në kuptim të nenit 366 par.1 të KPRK-së, e lidhur me nenin 43, 46 të KPRK-së, i shqiptoi dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi si në pikën e II për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi në rast së i pandehuri dështon, refuzon apo nuk mund të paguaj dënimin e shqiptuar me gjobë, është marrë konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 366 par.3 të KPRK-së, arma e markës cal. ...mm me numër serik, një (1) karikator i pistoletës së njëjtë si dhe pesë (5) fishekë të cal. 9mm, të

konfiskuara në bazë të vërtetimit mbi sekuestrimin e sendeve i datës 27.11.2023, gjykata i konfiskojë, dhe plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, urdhërohet Policia e Kosovës që ti shkatërrojë në përputhje me kushtet e përcaktuara ligjore.

Vendimi si në pikën e III të dispozitivit të këtij aktgjykimi lidhur me kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u marr në bazë të nenit 449 par. 1 dhe 2, nën par. 2.1 dhe nën par. 2.6, të KPPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIZIVIONI PENAL
P.nr.307/24, me datë 19.12.2024.

Bashkëpunëtore profesionale

Gjyqtarja e vetme gjyquese

Leonita Lajqi Mucaj

Blerta KELMENDI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet Gjykatës Themelore në Pejë.